



# Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit



Kabineti i Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA RAHOVEC / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
 KABINETI I KRYETARIT / KOMBINATI I KRYETARIT / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
 Nr./Br./No. 90 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 103  
 Data/Datum/Date 30 / 1 / 23  
 RAHOVEC / ORAHOVAC

## LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: 23- 27 JANAR 2023

| Nr  | Emri i vendimit                                                                                                                                                                              | Nr. Protokollit |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 1.  | Vendim për qasje në dokumente publike                                                                                                                                                        | NRP-02-67-2023  |
| 2.  | Vendim për themelimin e Komitetit Komunal Veprues (KKV)                                                                                                                                      | NRP-02-68-2023  |
| 3.  | Vendim për caktimin e komisionit për pranimin e ndihmave për familjet e komunve të përmytura nga shiu i rëmyeshëm                                                                            | NRP-02-70-2023  |
| 4.  | Vendim për formimin e Komisionit të Rekrutimit për zhvillimin e procedurave të pranimit në punë                                                                                              | NRP-02-71-2023  |
| 5.  | Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve                                                                                                                      | NRP-02-72-2023  |
| 6.  | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës                                                                                  | NRP-02-73-2023  |
| 7.  | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.02/3133/22 i datës 12.12.2022                                                                                                             | NRP-02-76-2023  |
| 8.  | Vendim për caktimin e juries profesionale për vlerësimin e punimeve dhe për përzgjedhjen e poezisë dhe prozës me rastin e manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit" | NRP-02-79-2023  |
| 9.  | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                 | NRP-02-84-2023  |
| 10. | Vendim për punët shtesë dhe punët e paparapara të Menaxherit të Projektit dhe raportit të Organit Mbikëqyrës                                                                                 | NRP-02-88-2023  |

Rahovec, Janar 2023





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine/Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET I PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 67 Nr. i faq./Br.su./No pg. 121

Data/Datum/Date 23/1/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/52/23, e datës 17.1.2023 për qasje në dokumente publike nga z. Valmir Ilazi nga Iniciativa për Progres (INPO) dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente për aktivitetin "Shërbimet e energjisë (ESCO) për Komunën e Rahovecit", dhe atë:
  - 1.1.Kërkesa për inicim të aktivitetit;
  - 1.2.Deklarata e nevojave për përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve dhe zotimin e mjeteve (të nënshkruar nga personat kompetent);
  - 1.3.Vendimin për caktimin e menaxherit të kontratës;
  - 1.4.Vendimi për krijimin e komisionit vlerësues;
  - 1.5.Deklarata nën betim e anëtarëve të komisionit vlerësues;
  - 1.6.Raporti i vlerësimit;
  - 1.7.Kërkesat për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së lidhur me to;
  - 1.8.Kopja e kontratës;
  - 1.9.Kopjen e planit të menaxhimit të kontratës;
  - 1.10. Siguria e tenderit;
  - 1.11. Siguria e ekzekutimit;
  - 1.12. Planin e menaxhimit të kontratës;
  - 1.13. Ofertat e OE-ve.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/52/23, e datës 17.1.2023 për qasje në dokumente publike nga z. Valmir Ilazi nga Iniciativa për Progres (INPO), për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtit i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike në lidhje me dokumente për aktivitetin "Shërbimet e energjisë (ESCO) për Komunën e Rahovecit" dhe atë: Kërkesa për inicim të aktivitetit; Deklarata e nevojave për përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve dhe zotimin e mjeteve (të nënshkruar nga personat kompetent); Vendimin për caktimin e menaxherit të kontratës; Vendimi për krijimin e komisionit vlerësues; Deklarata nën betim e anëtarëve të

komisionit vlerësues; Raporti i vlerësimit; Kërkesat për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së lidhur me to; Kopja e kontratës; Kopjen e planit të menaxhimit të kontratës; Siguria e tenderit; Siguria e ekzekutimit; Planin e menaxhimit të kontratës dhe Ofertat e OE-ve.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**VËREJTJE:** Duke marrë parasysh kapacitetin e madh në dosjen me nr. rendor 13 (Ofertat e OE-së) dhe pamundësisë së dërgimit të tij në formë elektronike, e njëjta do të dërgohet nëpërmjet postës në formë fizike në CD.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimin të tij.

**Vendimi u dërgohet:**

- **Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **z. Valmir Ilazi nga Iniciativa për Progres (INPO), dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br.No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 68 Nr. i faq/Br.str/No.pg 101

Data/Datum/Date 23/1/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008"), Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026 dhe Planit të Veprimit 2022 – 2024, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Komitetit Komunal Veprues (KKV)**

- Me këtë vendim **themelohet** Komiteti Komunal Veprues (KKV) në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
  - 1.1 Fatmir Iska – Nënkryetari i Komunës, udhëheqës
  - 1.2 Avni Morina – Drejtor i Drejtorisë për Arsime, anëtar
  - 1.3 Saranda Sallteku – Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
  - 1.4 Lendrit Qeli – Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar
  - 1.5 Habibe Haxhimustafa - Zyrtare për të drejtat e njeriut, anëtare
  - 1.6 Alban Gashi – Zyrtar për barazi gjinore, anëtar
  - 1.7 Ekrem Bytyqi – Zyrtar për Financa, anëtar
  - 1.8 Përfaqësuesi nga OJQ "SHL Kosova, anëtar
  - 1.9 Përfaqësuesi nga OJQ "SHPH Hareja", anëtar
  - 1.10 Përfaqësuesi nga OJQ "Geen – A", anëtar
  - 1.11 Përfaqësuesi nga OJQ "Këshilli Rinor i Rahovecit", anëtar
- Z. Lendrit Qeli caktohet Koordinator i Komitetit Komunal Veprues (KKV) në Komunën e Rahovecit.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit Komunal Veprues (KKV) janë të përcaktuara në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022 - 2026 dhe Planit të Veprimit 2022 – 2024.
- Komiteti Komunal Veprues është i obliguar që të mbajë së paku 6 (gjashtë) takime në vitë dhe ftohen nga udhëheqësi i Komitetit Komunal Veprues (KKV) përmes koordinatorit të Komitetit Komunal Veprues (KKV).
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komitetit Komunal Veprues (KKV).
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01/752/18 i datës 26.7.2018, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01/43/19 i datës 6.2.2019.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të KKV-së,
- ZKKK-së,
- MAPL-së dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

~~Komuna e Rahovecit~~

~~Opština Orahovac / Municipality Rahovec~~

~~Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor~~



~~VALI I KOSOVES / VICE PRESIDENT OF THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF KOSOVO~~

~~Titulli i Kryetarit të Komunës~~

~~Titulli i Kryetarit të Komunës~~

~~Titulli i Kryetarit të Komunës~~

~~Titulli i Kryetarit të Komunës~~

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për pranimin e ndihmave për familjet e komunave të përmbytura nga shiu i rrëmbyeshëm**

1. **Caktohet komisioni për pranimin e ndihmave (parave, veshmbathjeve, pakove ushqimore, pakove higjienike, gjërave për jetë normale, etj.) për familjet të cilat kanë pësuar dëme nga shiu i rrëmbyeshëm në Komunitat e Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:**
  - 1.1. Fatmir Iska– Nënkyetar i Komunës, koordinator (Kontakti +383 44 243 153 apo Fatmir.Iska@rks-gov.net)
  - 1.2. Saranda Sallteku– Drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale–anëtare (Kontakti +383 45 134 002 apo Saranda.Sallteku@rks-gov.net)
  - 1.3. Ymret Reshiti– Drejtor i Qendrës për Punë Sociale, anëtar (Kontakti +383 44 203 914 apo Ymret.Reshiti@rks-gov.net)
  - 1.4. Besnik Hoti– Drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar (Kontakti +383 45 331 300 apo Besnik.Hoti@rks-gov.net)
  - 1.5. Feriz Thaqi– Shoqëria Civile, anëtar (Kontakti +383 44 255 046)
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin, regjistrimin dhe evidentimin e personave dhe llojin e ndihmës së ofruar nga personat fizikë dhe juridikë për familjet të cilat kanë pësuar dëme nga shiu i rrëmbyeshëm në Komunitat e Republikës së Kosovës.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,
- Arkivit.







Komuna e Rahovecit / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
Opština Orahovac / Municipality Orahovac

№ 1. По № 1. 03 Кабинет и Крестарик и Комонс.

Nr./SeriNo 71 Nr. i faq./Br. str./No. pg 102

Date/Datum/Dt: 24 / 1 / 23

Y. T. Liang, H. B. Chen, and J. H. Chen

**V E N D I M**

1. Agron Thaqi, kryesues
- 1.1. Astrit Mullabazi, zëvendësues
2. Antigona Krasniqi, anëtare
- 2.1. Elma Shehu, zëvendësuese
3. Lulzim Krasniqi, anëtar
- 3.1. Jeton Krasniqi, zëvendësues
4. Skender Hamza, anëtar
- 4.1. Habibe Haxhimustafa, zëvendësuese
5. Skender Kokollari, anëtar( ekspert)

### III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

IV. Me vendim të njoftohet komisioni, Udhëheqësi i Personelit si dhe arkiva.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac / Municipality Rahovec**  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Nr. 02/Kryetari i Kryetarit të Komunës

72 Nr i faq/Br.str/No pg 102

Date 24 / 1 / 23

ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2018"), nenit 5 të Rregullores (QRK) – Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve**

1. Z. Valmir Gashi, i sistemuar në vendin e punës Zyrtar Ligjor, pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës, **CAKTOHET**:

**1.1. Zyrtar përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregulloren (QRK) – Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.
3. Obligohet z. Valmir Gashi që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregulloren (QRK) – Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01/94/19 i datës 20.3.2019.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Z. Valmir Gashi,
- Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 73 Nr. i faq./Br./str./No. pg. 102

Data/Datum/Date 24/1/23

ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

### V E N D I M

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, të martirëve dhe të civilëve” me numër të kontratës 623-21-4434-5-2-1/C294, si në vijim:
  - 1.1. Z. Sokol Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Koordinator i projektit “Ekipi Rajonal për Projekte Komunale (ERPK)”, sipas kontratës së AZHR-së, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2. Z. Afrim Oruqi, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3195/22 i datës 20.12.2022
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Me vendim të njoftohen:**

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presedni i Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRILSDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 76 Nr i faq/Br.sir/No.pg 102

Data/Datum/Date 25 / 1 / 23

RAHOVEC/ ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

### V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02/3133/22 i datës 12.12.2022

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/3133/22 i datës 12.12.2022 për miratimin e kërkesës së z. Gzim Sharku nga Rahoveci, me Nr. Protokolit 5350, të dt. 5.12.2022 për ndihmë financiare prej 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Pika 2 e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, me tekstin si në vijim:  
2.Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit dhe do të transferohen në xhirrollogari të Egzon Sharku, Nr. 2011000101493759 në TEB Bank.
3. Pikët tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/3133/22 i datës 12.12.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna Rahovec**



Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presedhnik Opštine – Mayor-Office

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIDSEDIJA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësi Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 79 Nr. i faq./Br.sir/No.pg 102

Data/Datum/Date 26 / 1 / 23

RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Konkursit për art letrar (poezi dhe prozë), të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 02/23 të dt. 10.1.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

**Për caktimin e jurisë profesionale për vlerësimin e punimeve dhe për përzgjedhjen e poezisë dhe prozës me rastin e manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit"**

1. Caktohet juria profesionale për vlerësimin e punimeve dhe për përzgjedhjen e poezisë dhe prozës me rastin e manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit", në këtë përbërje:
  - 1.1. Agime Kadriu, kryesuese
  - 1.2. Hazir Luta, anëtar
  - 1.3. Safet Spahiu, anëtar
2. Juria profesionale ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e të gjitha punimeve, të krijimtarive letrare, përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare dhe propozimin për krijimtarinë më të mirë letrare për dhënien e çmimit me rastin e manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit".
3. Obligohet juria profesionale që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Konkursin për art letrar (poezi dhe prozë), të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 02/23 të dt. 10.1.2023 si dhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. Juria profesionale do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e jurisë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të jurisë,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi  
Kryetari i Komunës



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac / Municipality Rahovec**  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] me Nr. Protokolit 06-553/01-0055415/22, e dt. 22.12.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### A r s y e t i m


[redacted] me datë 22.12.2022 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 15.12.2022 ka lindur vajzë në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë [redacted], si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

#### Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- **Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac/Municipality Rahovec**  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Njësi Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 88 Nr. i faq./Br.str/No. pg 103

Data/Datum/Date 27.1.23

W. HONTECAGRAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punët e paparapara e Menaxherit të Projektit dhe raportit të Organit Mbikëqyrës të datës: 27.1.2023, në projektin "Renovime në SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec" me Nr. të Prokurimit 623-22-9042-5-2-1, në shumën prej 7,220.00€ (shtatë mijë e dyqind e njëzet euro).
2. Ky vendim merret, pasi është konstatuar nga organi mbikëqyrës dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmerrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe të akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Arsim,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Organit Mbikëqyrës dhe
- Arkivit.

